

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës

LIGJET DHE TATIMET NË KOSOVË

P4

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI

Data 14/10/2017

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	<u>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK-PIKËT E DHËNA</u>
Zgjidhje shumëfishe	20	
1. Problemi 1	10	
2. Problemi 2	5	
3. Problemi 3	15	
4. Problemi 4	15	
5. Problemi 5	10	
6. Problemi 6	5	
7. Problemi 7	10	
8. Problemi 8	5	
9. Problemi 9	5	
Total	100	

Pjesa A. Pyetjet “rumbullakos përgjigjet”

Nga 1 pikë secila

1. Bazuar ne Ligjin Për Shoqëritë Tregtare: Brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga përfundimi i çdo viti kalendarik, shoqëria kolektive duhet që të llogarisë dhe regjistrojë të gjitha fitimet apo humbjet e bëra në atë vit, dhe të bëjë ndarjen e përqindjeve të fitimeve ose humbjeve në llogaritë e ortakëve të përgjithshëm.

E saktë

E pasaktë

2. Sipas Ligjit Për Shoqëritë Tregtare një pronar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar nuk është përgjegjës për borxhet ose detyrimet e shoqërisë vetëm për arsye se është pronar.

E saktë

E pasaktë

3. Zyra e regjistrimit të Shoqërive Tregtare dhe Emrave Tregtar në Kosovë themelohet si një agjenci e pavarur ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

E saktë

E pasaktë

4. Një person ose shoqëri tregtare e cila ka për qëllim ta shfrytëzojë një emër tregtar brenda një afati vijues prej treqindgjashtëdhjetë (360) ditësh mundet, ta rezervojë shfrytëzimin ekskluziv të këtij emri tregtar.

E saktë

E pasaktë

5. Shoqëritë tregtare, subjekte të ligjit “Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim”, duhet të verifikojnë të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e aseteve, të detyrimeve dhe të kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe evidencës së tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit.

E saktë

E pasaktë

6. Këshilli i Kosovës Për Raportim Financiar (KKRF) përbëhet nga tetë (8) anëtarë.

E saktë

E pasaktë

7. Bazuar ne Ligjin Për Administratën Tatimore dhe Procedurat si dhe ne udhëzimet përkatëse administrative, çdo person jo-rezident i cili i nënshtrohet çfarëdo tatimi në Republikën e Kosovës në pajtim me legjislacionin tatimor të Republikës së Kosovës, do të caktojë një përfaqësues fiskal përpara se të fillojë ndonjë veprimtari ekonomike në Republikën e Kosovës. Përfaqësuesi fiskal do të regjistrohet në ATK brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pasi të jetë emëruar.

E saktë

E pasaktë

8. Mospagesa e detyrimit tatimit ne kohen e parapare me ligjet tatimore, bazuar ne Ligjin Për Administratën Tatimore dhe Procedurat do te paguaje një interes prej 0.91% ne muaj apo pjese te muajit.

E saktë

E pasaktë

9. Bazuar në Ligjin Për Administratën Tatimore dhe Procedurat të gjitha tatimet duhet të vlerësohen brenda pesë viteve nga data kur deklarata tatimore me të cilën lidhet vlerësimi ka qenë obligues apo datën kur është paraqitur deklarata, cilado qoftë më e vona.

E saktë

E pasaktë

10. Sipas Ligjit Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Librat dhe regjistrimet minimale qe duhet mbaj një biznes me qarkullim vjetor bruto deri ne 50,000, apo me pak janë: libri i blerjes; libri i shitjes;libri i arkës.

E saktë

E pasaktë

11. Sipas ligjit nr. 05/L-029 Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave,të ardhurat e përfituara nga grandet, subvencionet dhe donacionet, në harmoni me rregullat dhe kushtet e përfitimit janë te ardhura te tatueshme.

E saktë

E pasaktë

12. Sipas ligjit nr.03/L-161 për Tatimin në të Ardhurat Personale, Tatimpaguesit janë: Personat fizikë rezident dhe jo rezident; Ndërmarrja personale afariste dhe Ortakëritë.

E saktë

E pasaktë

13. Sipas ligjit nr. 03/L-162 Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, një organizatë e regjistruar si organizatë jo qeveritare sipas Legjislacionit që rregullon regjistrimin dhe funksionimin e OJQ-ve, në Kosovës do të konsiderohet tatimpagues.

E saktë

E pasaktë

14. Sipas ligjit nr. 03/L-162 Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, shpenzimet e qirasë për një muaj përkatës të paguara në gjysmën e dytë të vitit në vijim janë shpenzime të periudhës përkatëse për qëllime tatimore duke respektuar parimin aktual.

E saktë

E pasaktë

15. Të ardhurat nga interesi i krijuar nga pagesa e Qeverisë së Kosovës në emër të bono thesarit është një e ardhur e tatueshme.

E saktë

E pasaktë

16. Sipas ligjit të TVSh-së, tatimi i llogaritur kuptojmë - TVSH-në në furnizimet të cilat i bënë personi i tatueshëm ose mallrat që i eksporton personi i tatueshëm.

E saktë

E pasaktë

17. Sipas Ligjit të TVSH-së, Notë krediti kuptojmë- dokument i lëshuar për qëllim të një rregullimi nga personi i tatueshëm për pranuesin e mallrave ose shërbimeve, pasi që të jetë lëshuar fatura tatimore ose një dokument që shërben si faturë, ku shuma e TVSH-së së ngarkuar në faturën tatimore ose në dokumentin që shërben si faturë, është me i vogël se obligimi real i TVSH-së për atë furnizim të tatueshëm.

E saktë

E pasaktë

18. Furnizimet e shërbimeve të lidhura me pasurinë e paluajtshme është vendi ku vendoset pasuria e paluajtshme sipas ligjit të TVSH-se.

E saktë

E pasaktë

19. Kompania Prishtina jep me qira veturën luksoze kompanisë T nga Tirana. Kompania nga Tirana veturën e pranon në Prishtinë tek selia e kompanisë . Ky transaksion është furnizim i pa tatueshëm.

E saktë

E pasaktë

20. Sipas ligjit të TVSh-së, nga data e kërkesës së tatimpaguesit për çregjistrim në TVSH, ATK detyrohet që brenda 12 muajve ta njofton tatimpaguesin për aprovimin ose jo të kërkesës.

E saktë

E pasaktë

21. Detyrimi për ngarkesë me TVSH për mallra dhe shërbime lind varësisht se cili nga tri momentet që ndodh i pari: pranimi i parasë, furnizim i mallit apo shërbimit dhe lëshimi i faturës në lidhje me furnizimin e mallit apo shërbimit .

E saktë

E pasaktë

22. Periudhat që lejohet paraqitja e një kërkesë për rimbursim të TVSH-së nëse janë plotësuar kriteret e rimbursimit është për çdo gjashtë muaj:

E saktë

E pasaktë

23. Sipas ligjit të TVSH-së bizneset e huaja duhet të regjistrohen në regjistrin e detyrueshëm të TVSH-së nga momenti i fillimit të aktivitetit të tyre në territorin e Kosovës

E saktë

E pasaktë

24. Fatura me TVSH sipas ligjit duhet ti ketë se paku tri elementet kryesore: datën e lëshimit; numrin rendor; numrat e TVSH-se dhe fiskal të të dy palëve;

E saktë

E pasaktë

25. Shkalla e akcizës për të gjitha produktet që zbatohet ka gjithmonë vlerë fikse dhe jo përqindje

E saktë

E pasaktë

26. Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës është person juridik i pavarur nën mbikëqyrjen e Kuvendit të Kosovës i themeluar me qëllimin e vetëm dhe ekskluziv të administrimit dhe menaxhimit të llogarive individuale për pensionet e bazuara në kursime.

E saktë

E pasaktë

27. Rasti i falimentimit fillon me paraqitjen e kërkesës me shkrim në gjykatë. Kërkesa mund të paraqitet nga kreditori apo një grup i kreditorëve nëse vlera e tërësishme e borxhit është mbi 3,000 Eur.

E saktë

E pasaktë

28. Sipas Ligji të Punës për punët me të gjata se orari i plot i punës gjegjësisht në orët për punë gjate natës pagesa shtese behet 30% me e lart.

E saktë

E pasaktë

29. Sipas Ligji te Punës puna provuese munde te zgjate me se shumti tre (3) muaj.

E saktë

E pasaktë

30. Sipas ligjit të TVSH dhënia dhe negocimi i kredisë dhe menaxhimi i kredisë nga personat që e ofrojnë atë është furnizim i liruar nga TVSH-ja;

E saktë

E pasaktë

31. Sipas ligjit të TVSH-së, ari, metalet tjera të çmueshme, bankënotat dhe monedhat metalike të importuara nga Banka Qendrore e Kosovës janë të obliguara të paguajnë TVSH me rastin e importit.

E saktë

E pasaktë

32. Personi i tatueshëm mund të zbres TVSH-në e zbritshëm edhe para periudhës tatimore në të cilën ai i ka pranuar faturat për mallrat apo shërbimet e furnizuara për të ose në të cilën ai ka pranuar deklaratën e doganës për mallrat e importuara.

E saktë

E pasaktë

33. Sipas ligjit te TVSH-se mallrat në valixhet personale të udhëtarit të cilat janë importuar për qëllime jo komerciale dhe të cilat janë të liruara nga pagesa e detyrimeve doganore në pajtueshmëri me legjislacionin doganor në fuqi janë të liruara dhe nga TVSH-ja.

E saktë

E pasaktë

34. Sipas Ligjit mbi Pensionet në Kosove, mosha e pensionimit për femra është mosha 62 vjeçare ndërsa për meshkuj është mosha gjashtëdhjetë e pesëvjeçare (65).

E saktë

E pasaktë

35. Sipas Ligjit mbi Pensionet në Kosove, për të gjitha kategoritë e personave të vetëpunësuar, minimumi i tremujorit të kontributeve do të jetë tridhjetë përqind (30%) të pagesës Minimale.

E saktë

E pasaktë

36. Kontributet pensional nga të punësuarit e huaj me qëndrim të përkohshëm në Kosovë, nuk janë të lejuara.

E saktë

E pasaktë

37. Sipas Ligjit mbi Pensionet në Kosove, nëse Fondi konstaton se një punëdhënës, punonjës apo person i vetëpunësuar ka dhënë kontribute të tepërta, Fondi mund t'i kthejë kontributet e tilla të tepërta në pajtim me rregullat e Administratës Tatimore të Kosovës

E saktë

E pasaktë

38. Sipas Ligjit mbi Pensionet në Kosovë, njëri nga disa llojet e pensioneve vjetore është edhe lloji: pensioni vjetor i të mbijetuarit është i pagueshëm gjatë jetës së pjesëmarrësit dhe pastaj gjatë jetës së bashkëshortit të saj ose bashkëshortes së tij për pjesën e mbetur të jetës së saj apo të tij.

E saktë

E pasaktë

39. Sipas Ligjit të Punës, asnjë punëdhënës nuk mund të lidhë kontratë pune me ndonjë person nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç.

E saktë

E pasaktë

40. Sipas ligjit të Punës, punëdhënësi në sektorin privat, është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës.

E saktë

E pasaktë

Pjesa B. Pyetjet problemore

Problemi 1

10 pikë

F&E sh.p.k. regjistroi blerje gjate Dhjetor 2014 ne shumën Eur 320 000, shitjet vendore Eur 550 000 ,eksportet Eur 48,200, shitje te përjashtuara pa te drejt kreditimi Eur 105 000 (Vlerat e paraqitura janë pa përfshire TVSH-ne).

Koeficienti i TVSH-se se zbritshme për vitin 2013 ishte 75%.

Koeficienti i TVSH-se se zbritshme për vitin 2014 rezultojë te jete 65%(TVSH qe duhet te rregullohet për ketë vit është 15,000)

Kërkohet:

A ka detyrim TVSH-se për te paguar ne muaj Dhjetor 2014 për F&E, nëse po sa është obligimi?

Zgjidhje

Libri i shitjeve

Shitje të përjashtuar	105,000
Export	48,200
Shitjet	$550\,000 \times 16\% = 88,000$
<u>Rregullimi i TVSH-se për koefic.</u>	<u>15,000</u>

TOTAL TVSH e llogaritur 103,000

Libri i blerjeve

Blerjet pa të drejtë kreditimi *	129,920
<u>Blerjet $(320,000 \times 16\% = 51,200 \times 65\%)$</u>	<u>= 33,280</u>
TOTAL TVSH e zbritshme	33,280

TVSH e pagueshme = TVSH e llogaritur - TVSH e zbritshme

TVSH e pagueshme = $103,000 - 33,280$
 = 69,720 (obligim për pagesë)

* $320,000 \times 35\% = 112,000$

$51,200 \times 35\% = 17,920$

Problemi 2**5 pikë**

Kompania Max SH,P.K për vitin qe përfundon si me 31.12.2015 kishte një fitim para donacioni 200,000 EUR . Shpenzimet e donacionit për këtë viti ishin 35,500 EUR.

Kërkohet:

Llogaritni obligimin tatimor pas rregullimeve të nevojshme bazuar ne Ligjin mbi të ardhurat e korporatave për kompaninë Maxi Sh.p.k. me 31.12.2015.

Zgjidhje

Fitimi Para Donacionit	200,000
<u>1*Shpenzimet e Donacionit</u>	<u>(20,000)</u>
Fitimi para tatimit	180,000
Obligimi Tatimit ne Fitim	(18.000)

1* 200,000*10%=20,000 (limiti sipas ligjit)

35,500-20,000= 15,500 (shpenzim i pa zbritshëm)

Problemi 3**15 pikë**

Kompania Nojtra SH,P.K për vitin që përfundon me 31.12.2015 kishte një qarkullim EUR 1,000,000. Shpenzimet e përgjithshme ishin EUR 800,000.

Informacion shtesë: Te gjitha këto shpenzime si me poshtë janë përfshirë në shpenzimet e përgjithshme me përjashtim të pikës 3.

1. Provizioni i përgjithshëm për llogarit e arkëtushme sipas menaxhmentit për këtë viti ishte 2% e shumës së tërësishme të llogarive të arkëtushme (llogarit e arkëtushme me 31.12.2015 kanë vlerën bruto 100,000 EUR).
2. Shpenzimet e zhvlerësimit të aseteve ishin me të ulëta sipas kontabilitetit financiar në raport me llogaritjen e kontabilitetit të tatimeve për j 6,000 EUR .
3. Është blerë një aset i grupit të tretë në vlerë prej 45,000 EUR, nuk është aplikuar zbritja e posaçme për pasurin e re.
4. Shpenzimet e përfaqësimit kanë shumën prej 12,500 EUR.
5. Shpenzimet e donacionit për këtë vit janë 35,000 EUR , por në këtë shumë është përfshirë edhe një sponsorizim i veçantë i njohur sipas ligjit në vlerë prej 10,000 EUR.

Kërkohet:

Llogaritni obligimin tatimor pas rregullimeve të nevojshme bazuar në Ligjin mbi të Ardhurat e Korporatave për kompaninë NOJTRA Sh.p.k. me 31.12.2015

Zgjidhje

Te ardhurat	1,000,000
SHP	(800,000)
Fitimi Kontabël	200,000
Rregullimet:	
Provizioni(1*)	2,000
Zhvlerësimi (2*)	(6,000)
Zbritja e posaçme(3*)	(4,500)
Shpenz. përfaqësimit (4*)	2,500
Donacioni	35,000
Fitimi par Donacionit	229,000
Donacioni(5*)	(32,900)
Fitimi para tatimit	196,100
Tatimi (10%)	19,610

1* Provizionimi i llogarive te arktushme pa u shndërruar ne borxh te keq sipas ligjit te TAK nuk është shpenzimi i zbritshëm për qëllime tatimore.

2* Për qëllime tatimore shpenzimet e zhvlerësimit njifen ne vlerën e paraparë sipas përqindjes se lejuar ne ligjin e TAK.

3* Zbritje e posaçme për asetin e ri lejohet 10% e vlerës kushtuese vetëm ne vitin e blerjes
Vlera e asetit $45,000 \times 10\% = 4,500$ shpenzim për zbritje e posaçme

4* Shpenzimet e përfaqësimit

Qarkullimi $1,000,000 \times 1\% = 10,000$ (limiti i shpenzimeve te lejuara)

Shpenzimet e përfaqësimit $12,500 - 10,000 = 2,500$ (shpenzime te pa lejuara)

5* Donacioni pranohet ne tërësi si shpenzim pasi qe është nen limitin e lejuar nga Ligji TAK (10% e fitimit para donacionit + 10% kur kemi spozorizime te veçanta sipas ligjit)

Sqarim shtesë pika 5 : 229,000 fitimi para tatimit (10% donacioni i lejuar 22,900),

donacioni i aplikuar 25,000 (35,000 - 10,000), diferenca 2,100€ (25,000 - 22,900)

Sponsorizim i veçantë është 100% i pranuar pasi $229,000 \times 0.1 = 22,900$; $22,900 - 10,000$ e lejuar me tepër.

Donacioni i rregullt	22,900
<u>Donacioni si sponsorizim i veçantë</u>	<u>10,000</u>
Total	32,900

Problemi 4**10 pikë**

Banka Komerciale "DELTA" regjistroi blerje gjatë Maj/2015 në shumën 125,000€ (të gjitha blerjet janë me fatura të rregullta përfshirë TVSh-në), të ardhurat nga interesi në këtë muaj ishin 300,000€.

Në këtë muaj DELTA ka pranuar edhe një faturë shërbimi nga kompania konsulente BENDA me seli në Londër në vlerë prej 32,000 EUR.

Kërkohet:

A ka detyrim të TVSH-së për të paguar në këtë muaj Banka komerciale "DELTA", nëse po sa është obligimi?

Zgjidhje

Libri i shitjeve

Shitjet	300,000
<u>Ngarkesa e kundërt</u>	<u>32,000 x 16% = 5,120</u>
TOTAL TVSH e llogaritur	5,120

Libri i blerjeve

Blerjet pa te drejt kreditimi	125 000
<u>Blerjet pa te drejte Kreditimi (NK 32,000+16%)</u>	<u>37 120</u>
TOTAL TVSH e zbritshëm	0

TVSH e pagueshme = TVSH e llogaritur - TVSH e zbritshëm

TVSH e pagueshme = 5,120

Problemi 5**10 pikë**

ORA sh.p.k. në muajin prill 2015 ka pranuar aktin final të kontrollit për periudhën Janar/2014 për TVSH. Ne aktin final ATK ka konstatuar tatim shtesë prej 10,200€.

Kompania ka deklaruar dhe paguar në kohën e paraparë me ligj për këtë periudhë tatimore shumë prej 30,800€.

Kërkohet:

Sa janë gjordat dhe interesi për këtë tatim shtesë që kompania pagojë duke u bazuar në kalkulimet që parasheh Ligji mbi procedurat dhe Administratën Tatimore ?

Zgjidhje

1*.Gjorda për nën deklarim tatimor	$10,200 \times 25\% = 2,550$
2* Gjorbë për mos pagesë të tatimit (1% në muaj)	$10,200 \times 12\% = 1,224$
3* Interesi 0.91 % ne muaj	$10,200 \times 13,65\% = 1,392$
TOTALI	5,166

1* Neni 52 pika 1.2 i ligjit për procedurat e ATK-së- nëse nën deklarimi është më i lartë se 10 % ndëshkimi është 25% i shumës së nën deklaruar.

2*Neni 51 pika 2 i ligjit Proc. ATK për mos pagesë të tatimit në kohë ndëshkim 1% për muaj max 12 muaj

3* Neni 28 pika 1 i ligjit Proc. ATK-së, deri në dite e pagese të tatimit llogaritet interes 0.91% në muaj. Ne rastin konkret ne kemi të bëjmë me 15 muaj mos pagese të tatimit.

Problemi 6**5 pike**

Kompania LTE Sh.p.k për muajin Nëntor 2015 kishte 3 të punësuar me të ardhura bruto si me poshtë:

Menaxheri - 1,000 EUR

Stafi 1 - 600 EUR

Stafi 2 - 450 EUR

Stafi 2 është i angazhuar me kontratë mbi vepër.

Kërkohe:

a. Kalkuloni Kontributin pensional për muajin Nëntor/2015

b. Kalkuloni Tatimin në të ardhura personale për muajin Nëntor/2015

Zgjidhje

a) KP

1. Menaxheri $1000 \times 5\% = 50$

KP = $50 + 50 = 100$

2. Stafi 1 $600 \times 5\% = 30$

KP = $30 + 30 = 60$

3. Stafi 2 $450 \times 5\% = 22.5$

KP = $22.5 + 22.5 = 45$

TOTAL KP 205 EUR

b) TAP

1. Menaxheri $1000 - 50 = 950$

$0 - 80 = 0$

$80 - 250 = 4\% - 170 \times 4\% = 6.8$

$250 - 450 = 8\% - 200 \times 8\% = 16$

$450 - 950 = 10\% - 500 \times 10\% = 50$

TAP = 72.80

$$1. \text{ Stafi 1 } 600 - 30 = 570$$

$$(6.8 + 16) + 450 - 570 \times 10\% = 6.8 + 16 + 120 \times 10\% = 6.8 + 16 + 12$$

$$\text{TAP} = 34.80$$

$$\text{Stafi 2 } 450 - 22.5 = 427.50$$

$$427.50 \times 10\% = 42.75$$

$$\underline{\text{TAP} = 42.75}$$

$$\underline{\text{TOTAL TAP} = 72.80 + 34.80 + 42.75 = 150.35}$$

Problemi 7**10 pike**

Kompania L&L SH.A. më datë 31.12.2014 kishte këtë gjendje të aseteve sipas kontabilitetit (Kosto Historike) :

Grupi I - 250,500€

Grupi II - 90,000€

Grupi III - 350,000€

Grupi (1,000-3,000) - 12,200€

Një aset prej 10,000€ që i takon grupit të dyte ishte blerë në Gusht 2014.

Te gjitha asetet janë blerë pas datës Janar 2011.

Kërkohe:

Të llogaritet zhvlerësimi sipas Ligjit Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave.

Zgjidhje

Grupi I

$$\underline{250,500 \times 5\% = 12,525}$$

Grupi II

$$80,000 \times 20\% = 16,000$$

$$\underline{10,000 \times 20\%/2 = 1,000}$$

$$17,000$$

Grupi III

$$\underline{350,000 \times 10\% = 35,000}$$

Grupi (1000-3000)

$$\underline{12,200 \times 20\% = 2,440}$$